



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:240935

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05652550

**P.nr.../...**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL** gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit A... G... për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.2079/23 të datës 02.11.2023, jashtë seancës gjyqësore me datë 03.05.2024 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.../.. e datës ....., lidhur në mes të pandehurit A... G... dhe të dëmtuarit A... S... nga P... rr. H... K...

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr. 2079/23 të datës 02.11.2023.

**III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit A... G..., i lindur më ....., në Pejë, tani me banim në fshatin B... Komuna P..., nga babai L... dhe nëna T... e vajzërisë S..., i martuar ka të kryer shkollën e mesme, punëtoare, i gjendjes se dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i nacionalitet shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

- për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 02.11.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.2079/23 ndaj të pandehurit A... G... për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Me datën ..... është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit pandehurit A... G... dhe të dëmtuarit A... S..., me nr, Nd.nr.../.. e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.402/24 e datës ....., lidhur në mes të pandehurit A... G... dhe të dëmtuarit A... S....

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
2023:240935, 03.05.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

**Gjyqtari**

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi